



**ODA E INXHINIERËVE  
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Nr. 44-BD/2025  
Prishtinë: 28.10.2025

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nënparagrafi 5.8 dhe 5.13 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, dhe në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9 dhe 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24; dhe duke u bazuar në Raportin e Vlerësimit të Komisionit Vlerësues të datës 28.10.2025, të hartuar me Vendimin Nr. 17-BD/2024, për themelimin e Komisionit për blerje, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 28.10.2025, nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. Miratohet raporti i përzgjedhjes së ofruesit i Komisionit Vlerësues i datës 28.10.2025 për "Blerja e 5 (pesë) karrigeve për administratën e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)". Oferta fituese përzgjedhet oferta e Comfort Furniture SHPK.
2. Miratohet raporti i përzgjedhjes së ofruesit i Komisionit Vlerësues i datës 28.10.2025 për "Përzgjedhja e operatorit ekonomik për furnizim me ujë të pijshëm të ambalazhuar për zyrat e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)". Oferta fituese përzgjedhet oferta e ADEA Group SHPK (Ujë DEA).
3. Autorizohet Kryetari i OIRK-së, z. Arsim Rapuca, për blerjen e karrigeve mbështetur në nenin 1 të këtij vendimi si dhe nënshkrimin e kontratës me ADEA Group SHPK (Ujë DEA) për furnizim të rregullt me ujë mbështetur në nenin 2 të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Bordit Drejtues të OIRK-së
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**  
Kryetar i OIRK-së \_\_\_\_\_
2. **Mimoza Shahini**  
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
3. **Kadri Morina**  
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
4. **Afrim Demiri**  
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
5. **Nebi Pillana**  
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
6. **Bujar Jupaj**  
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
7. **Sami Kolgeci**  
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_



# ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## RAPORT I VLERËSIMIT TË OFERTAVE

### Lënda:

Blerja e 5 (pesë) karrigeve për administratën e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)

**Data:** 28.10.2025

### Komisioni Vlerësues:

- Arsim Rapuca, Kryesues
- Afrim Demiri, Anëtar
- Bujar Jupaj, Anëtar

### 1. Përshkrimi i procesit të vlerësimit

Me qëllim të furnizimit me 5 (pesë) karrige për nevojat e administratës së OIRK-së, janë kërkuar oferta nga tri kompani të ndryshme të licencuara dhe aktive në tregun e mobiljeve zyrtare.

Kërkesa është bërë në datat 23–24 tetor 2025, dhe në afatin e përcaktuar janë pranuar ofertat nga këto kompani:

| Nr. Emri i kompanisë        | Numri i biznesit (NRB) | Qyteti       | Data e ofertës |
|-----------------------------|------------------------|--------------|----------------|
| 1 Comfort Furniture SH.P.K. | 811487421              | Fushë Kosovë | 24.10.2025     |
| 2 Punto SH.P.K.             | 811256298              | Prishtinë    | 23.10.2025     |
| 3 Vranina SH.P.K.           | 810197683              | Pejë         | 24.10.2025     |

### 2. Përmbajtja e ofertave

#### a) Comfort Furniture SH.P.K.

- Ofron disa modele të karrigeve menaxheriale dhe ekzekutive prej lëkure, me mekanizëm ergonomik dhe garancion 6 muaj për rrotat, cilindrin dhe mekanizmin.
- Çmimet pas zbritjes variojnë nga **99 € deri në 139 €**.



## ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

- **Modeli 818**, i materialit lëkurë me mekanizëm ergonomik dhe pjesë për shtrirjen e këmbëve, ofrohet me çmim **139 €** dhe cilësohet si produkt me rehati të lartë për përdorim të përditshëm administrativ.

### b) Punto SH.P.K.

- Ofertë e gjerë me karrige ergonomike lëkure dhe rrjete, me garancion 12 muaj.
- Çmimet pas zbritjes variojnë nga **99 € deri në 386 €**.
- Modelet janë kryesisht me dizajn modern dhe mekanizma shumëfunksionalë, por me çmime mesatare më të larta në raport me nevojat dhe buxhetin e OIRK-së.

### c) Vranina SH.P.K.

- Ofroi modele të reja dhe të përdorura të karrigeve lëvizëse.
- Çmimet për modelet e reja variojnë nga **120 € deri në 370 €**, ndërsa për ato të përdorura nga **100 € deri në 190 €**.
- Nuk përfshihet garancion, dhe disa nga produktet janë të gjendjes së dytë (të përdorura), çka e ul përputhshmërinë me kërkesat për standard administrativ.

### 3. Krahasimi i përgjithshëm

| Kompania               | Çmimi mesatar me zbritje | Garancioni       | Lloji i produkteve          | Përputhshmëria me kërkesën    |
|------------------------|--------------------------|------------------|-----------------------------|-------------------------------|
| Comfort Furniture SHPK | 99 € – 139 €             | 6 muaj           | Lëkurë, mekanizëm ergonomik | Shumë e lartë                 |
| Punto SHPK             | 117 € – 386 €            | 12 muaj          | Lëkurë / rrjetë             | E mirë, por çmime më të larta |
| Vranina SHPK           | 100 € – 370 €            | Nuk specifikohet | Disa të përdorura           | E ulët                        |

### 4. Arsyeja e përzgjedhjes

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të të gjitha ofertave në aspektin e:



## ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

- cilësisë së produkteve,
- përputhshmërisë me nevojat e administratës,
- garancionit,
- dhe çmimit më ekonomik,

Komisioni Vlerësues ka konstatuar se oferta më e përshtatshme dhe më ekonomike është ajo e kompanisë **Comfort Furniture SHPK**, konkretisht modeli me kodin **818**, me çmim për njësi **139 €**, për shkak të:

- materialit cilësor (lëkurë),
- mekanizmit ergonomik të avancuar,
- pjesës shtesë për shtrirjen e këmbëve,
- dhe raportit shumë të mirë çmim–cilësi.

### 5. Rekomandimi i komisionit

Komisioni rekomandon që Bordi i Odës së Inxhinierëve e Republikës së Kosovës të vazhdojë me blerjen e 5 (pesë) karrigeve model 818 nga Comfort Furniture SHPK, me çmim njësie 139 € dhe çmim total 695 € (pa TVSH).

### 6. Nënshkrimet e Komisionit Vlerësues

Emri dhe mbiemri Pozita në Komision Nënshkrimi

Arsim Rapuca Kryesues

Afrim Demiri Anëtar

Bujar Jupaj Anëtar